



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 49-32238 /2023

Klinë, datë 12/09/2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr.03/L-040, në nenit 91 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Klinës, në nenin 2 pika 2.3 dhe nenin 4 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr.03/L-49, dispozitat e nenit 12 të Rregullores për përmbajtjen e simboleve komunale si dhe procedurën mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera nr.01-06-4414/2015, në përputhje edhe me nenin 8 pika 1.6 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, si dhe duke marrë parasysh vendimin e jurisë për përzgjedhjen e përfituesit të çmimit "Ora e Tahir Deskut" si dhe Rekomandimin e DKRS të datës 08.09.2023, Kryetari i Komunës së Klinës, mori;

V E N D I M

1. **LEJOHËT**, ndarja e mjeteve financiare në shumën prej **100.00 €** (njëqind euro) për manifestimin letrar "**Ora e Tahir Deskut**", përkatësisht fituesin e çmimit të parë në poezi, Vlora Rexhaj. Ky manifestim mbahet, në shënjë nderi dhe respekti për kontributin e dhënë të Tahir Deskut, në fushën letrare, kombëtare dhe intelektuale. Mjetet në shumën prej 100.00 € paguhen nga subvencionet e Drejtorisë së Kulturës.
2. Mjetet si nga pika 1 e këtij vendimi derdhen në xhirollogari të Vlora Rexhaj.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është, vendimi i jurisë profesionale, i datës 06.09.2023, Rekomandimi i DKRS i datës 08.09.2023, vendimi i DKRS për formimin e jurisë profesionale i datës 06.09.2023, si dhe dokumentacioni personal i fituesit të çmimit.
4. Për ekzekutimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës.
5. Ky vendim është i plotëfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Të njoftohen:

- DFEZH;
- Vlora Rexhaj;
- DKRS, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj

